



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2022

VENDIM

Nr. 46, datë 08.02.2022

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019,
GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS
SË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë” dhe nr. 193, datë 12.05.2021, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i hartuar nga relatorë znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të njohurive dhe arsytimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit, bazuar në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij, relacionet/opinionet ligjore të përgatitur prej tij për çështjet e përzgjedhura me short dhe burimet e tjera të vlerësimit. Aftësia profesionale e ndihmësmagjistratit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultoi se:

- *Në lidhje me përcaktimin dhe renditjen e rrethanave të çështjes:*

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi faktet e çështjes janë renditur në pjesën hyrëse të relacionit, nën titullin “Rrethanat e çështjes”, duke u përshkruar në mënyrë të sintetizuar, si dhe duke referuar në çdo rast në faktet e provuara në gjykim, sipas provave dhe akteve të administruara gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe/ose gjykatën e apelit. Në varësi të natyrës së çështjes dhe kompleksitetit të saj, faktet e çështjes përshkruhen në dy ose shumë paragrafë, gjithnjë në mënyrë të qartë dhe koncizë.

Evidentohet aftësia e ndihmësmagjistratit për t’i ekstraktuar dhe parashtruar faktet e çështjes, thjesht dhe në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke u ndalur më gjatë në elementët thelbësore të fakteve të çështjes të cilat kanë rëndësi për shkaqet e objektit të mjetit procedural që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, si dhe duke mos e ngarkuar përmbajtjen e aktit me fakte dhe rrethana të cilat nuk i shërbejnë këtij qëllimi. Në raste specifike, ndihmësmagjistrati ka bërë pjesë të rrethanave të çështjes, edhe referimin e drejtpërdrejtë apo citimin¹ në disa raste të përmbajtjes së akteve apo provave mbi të cilat mbështetet fakti i provuar, me qëllim qartësimin e elementëve që janë vlerësuar thelbësore në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Po ashtu, në çështje në të cilat thelbi i rekursit bazohet në rrethana procedurale, ndihmësmagjistrati është ndalur vetëm në këto elementë, duke dhënë në mënyrë telegrafike elementët që lidhen me faktin objekt gjykimi, siç është rasti i trajtimit të çështjes së juridiksionit² apo trajtimit të kërkesës për rishikim vendimi³ apo i trajtimit të pasojave të

¹Relacion për çështjen administrative me nr. 31001-04678-2014, datë regjistrimi 23.12.2014.

²Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.

³Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01733-2015, datë regjistrimi 02.09.2015.

mosparaqitjes së të dëmtuarit akuzues në çështjet e iniciuara sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale⁴.

- ***Në lidhje me evidentimin e ecurisë procedurale të çështjes:***

Në drejtim të renditjes së ecurisë procedurale të çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, menjëherë pas paraqitjes në mënyrë të përmbledhur të fakteve thelbësore të çështjes dhe, kur është rasti, edhe të qëndrimit të mbajtur nga organi administrativ që ka shqyrtuar çështjen në rrugë administrative⁵, rezulton të jetë evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të qartë qëndrimi i gjykatave të faktit dhe në mënyrë të përmbledhur thelbi i arsytimit të tyre në lidhje me faktet kryesore të çështjes. Ndhmësmagjistrati evidenton në çdo rast qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë (*e juridiksionit të përgjithshëm ose të posaçëm*) apo Gjykata e Apelit në rastet kur ajo ka shqyrtuar çështje që janë në juridiksion fillestar të kësaj gjykate⁶, duke pasqyruar në fillim dispozitivin e vendimit. Pas këtij momenti paraqitet në një ose disa paragrafë, në mënyrë të përmbledhur, pjesa thelbësore e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen, duke i kushtuar rëndësi pasqyrimin të atyre pjesëve të arsytimit që lidhen drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, por edhe me shkaqet e rekursit/ankimit të veçantë. Më pas, citohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit, duke vijuar më tej me pasqyrimin e pjesëve thelbësore të arsytimit, vetëm në ato raste kur qëndrimi i Gjykatës së Apelit ndryshon nga ai i gjykatës së shkallës së parë. Në rastet kur ky qëndrim është i njëjtë, ndihmësmagjistrati ka pasqyruar faktin se qëndrimi i gjykatës së apelit është mbështetur në të njëjtin arsyetim si gjykata e faktit, duke mos ri sjellë pjesë të arsytimit të vendimit nga gjykata e apelit. Në rastet kur qëndrimi dhe/ose arsyetimi i gjykatës së apelit është i ndryshëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë, ndihmësmagjistrati ka pasqyruar pjesë të arsytimit të vendimit, duke u fokusuar vetëm në ato që janë thelbësore dhe mbështetin qëndrimin e ndryshëm të gjykatës së apelit⁷.

- ***Në lidhje me shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë:***

Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, shkaqet e rekursit paraqiten në një pjesë me vete të relacionit, menjëherë pas paraqitjes së ecurisë procedurale të çështjes dhe qëndrimit të gjykatave të faktit. Në pasqyrimin e shkaqeve të rekursit, pas evidentimit të palës që ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe ka investuar Gjykatën e Lartë, ndihmësmagjistrati ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur shkaqet thelbësore të rekursit/ankimit të veçantë të paraqitur nga pala.

Shkaqet e rekursit ose ankimit të veçantë⁸, në të gjitha dokumentet ligjore të administruara renditen në mënyrë të qartë dhe koncize duke i shërbyer orientimit të drejtë të çështjeve të shtruara për zgjidhje, lidhur me zbatimin e ligjit procedural dhe/ose material për të cilat pala i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Në rastin e investimit të Gjykatës së Lartë me mjete të tjera ligjore, të ndryshme nga rekursi, sikurse është rasti i kërkesës për rishikim vendimi⁹ apo ankim ndaj vendimit të gjykatës lidhur me juridiksionin gjyqësor¹⁰, shkaqet e

⁴ Relacion për çështjen penale me nr. 52810-00798-002916, datë regjistrimi 06.05.2016.

⁵ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.

⁶ Relacion për çështjen administrative me nr. 31001-04678-00-2014, datë regjistrimi 23.12.2014.

⁷ Relacion për çështjen civile me nr. 11243-04580-00-2014, datë regjistrimi 15.12.2014.

⁸ Relacion për çështjen me nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.

⁹ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01733-00-2015, datë regjistrimi 02.09.2015.

¹⁰Relacioni për çështjen administrative me nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.

ankimit/kërkesës për rishikim vendimi, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur me një paragraf, referuar natyrës jo komplekse të çështjes mbi të cilën është iniciuar nga Gjykata.

- ***Në lidhje me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i mosmarrëveshjes dhe rrethanat e çështjes të përshkruara në pjesën hyrëse të relacionit apo objekti i kërkesës, pavarësisht se nuk rezulton të jetë përcaktuar në mënyrë deklarative nga ndihmësmagjistrati në rekursit e analizuara. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe konciz i fakteve të çështjes, si dhe ecuria procedurale e gjykimit, sjell si pasojë identifikimin e saktë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, si dhe përcakton natyrën specifike të çështjes, sipas objektit të saj (*marrëdhënie pune, pavlefshmëri akti administrativ, kundërshtim veprimesh përmbaremore, çështje penale, kërkesë për rishikim vendimi, ankim ndaj vendimit lidhur me juridiksionin gjyqësor, kundërshtim veprimesh përmbaremore, etj.*).

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes përveç lidhjes së drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës/kolegjit për shqyrtimin e çështjes, lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe/ose material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve ligjore burim vlerësimi, rezulton se në të gjitha rastet ndihmësmagjistrati ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm, i cili rezulton të jetë pjesë e përmbajtjes dhe në disa raste, kur është vlerësuar e nevojshme, edhe e analizës ligjore më të zgjeruar, në pjesën e mendimit të ndihmësmagjistratit.

Referuar natyrës komplekse ose jo të çështjes, si dhe shkaqeve të ankimit/rekursit/kërkesës nëpërmjet së cilës është investuar Gjykata e Lartë, ndihmësmagjistrati, në pjesën e mendimit apo vlerësimit ligjor të tij, ka referuar dhe në disa raste cituar dispozita të ligjit material dhe/ose procedural. Konkretisht:

- (i) Referuar kushteve procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim vendimi, identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 496 të K.Pr.C, në të cilin parashikohet afati i paraqitjes së kërkesës për rishikim si dhe afati prekluziv për paraqitjen e saj, në raport me momentin e lindjes së shkakut të rishikimit¹¹.
- (ii) Referuar ankimit të veçante mbi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë mbi kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në shërbim të analizës lidhur me kushtet thelbësore të padisë, në raport me çështjen e juridiksionit, identifikon nenin 16 të ligjit nr. 49/2012. Po ashtu për të vlerësuar çështjen e juridiksionit gjyqësor, identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 70, pika 2 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, nenin 51 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Po ashtu referon në analizë nenin 38 dhe 16/2 të ligjit nr. 49/2012, nenin 129 dhe 133 të K.Pr.A, si dhe nenet 282, pika 4 dhe 6 të Kodit Doganor, dhe nenin 109, pika 2 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, në mbështetje të interpretimit të bërë

¹¹ Relacion për çështjen civile me nr. 31003-01733-00-2015, datë regjistrimi 02.09.2015.

lidhur me kuptimin e nenit 133 të K.Pr.A. Po ashtu, në mbështetje të analizës së tij lidhur me përputhjen me ligjin dhe kushtetutën të VKM-së së referuar si më sipër, identifikon si ligj të zbatueshëm edhe nenet 17 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹².

- (iii) Referuar shkaqeve të ngritura në rekurs, në shërbim të vlerësimit të tij se rekursi i palës nuk përmban shkaqe ligjore, identifikon nenin 443/2 të K.Pr.C dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, si dhe për të mbështetur argumentin se vendimet e gjykatave më të ulëta janë të drejta referon nenin 9, pika 3 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin dhe vlefshmërinë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”¹³.
- (iv) Referuar shkaqeve të ngritura në rekurs, në mbështetje të mendimit se ai nuk përmban shkaqe ligjore, në disa raste ka identifikuar si ligj të zbatueshëm vetëm nenet respektive që parashikojnë shkaqet e rekursit dhe konkretisht nenin 58 të ligjit nr. 49/2012¹⁴.
- (v) Referuar shkaqeve të rekursit, në mbështetje të mendimit të tij për vlerësimin në rrugë incidentale të kushtetutshmërisë së aktit nënligjor të zbatueshëm në çështjen konkrete, ka referuar si ligj të zbatueshëm, veç nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 lidhur me shkaqet e rekursit, edhe nenin 28 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 119 të Kushtetutës dhe aktin nënligjor, Rregulloren nr. 78, datë 16.04.2010 të Prokurorit të Përgjithshëm¹⁵.
- (vi) Referuar shkaqeve të rekursit dhe vendimmarrjes së gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, referon nenin 432 të K.Pr.P lidhur me shkaqet e rekursit si dhe nenin 59 të po këtij Kodit, lidhur me pasojat e mosparaqitjes së të dëmtuarit akuzues lidhur me përfundimin e çështjes penale të iniciuar prej tij.
- (vii) Referuar shkaqeve të rekursit, në mbështetje të mendimit se rekursi përmban shkaqe të ligjshme, referon nenin 443/2 të K.Pr.C dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 si dhe nenin 193 të K.Pr.C lidhur me cilësinë procedurale të personit të tretë në gjykim, në mbështetje të qëndrimit të tij se është i nevojshëm unifikimi i praktikës gjyqësore lidhur me pasojat e mos thirrjes së personit të tretë gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Po ashtu, në secilin dokument ligjor të analizuar, në hyrje të pjesës në të cilën pasqyrohet mendimi i ndihmësit ligjor, identifikohet, sipas rastit neni 435/1 i K.Pr.P ose neni 443/2 i K.Pr.C lidhur me afatin e paraqitjes së rekuetit, neni 443/4 i K.Pr.C lidhur me afatin e ankimit të veçantë dhe neni 496 i K.Pr.C lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës për rishikim vendimi.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave në dokumentet ligjore të analizuar nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por nga ana tjetër, në dy raste, në mendimin e tij juridik të ndihmësmagjistratit ngrihet çështja mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit nënligjor të zbatueshëm, konkretisht:

- (i) Lidhur me nenin 4/2 të VKM nr. 1181, datë 21.10.2009, duke sugjeruar vlerësimin nëpërmjet gjykimit incidental lidhur me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e kësaj dispozite në raport me konceptin e « rezervës ligjore » si dhe natyrën e

¹² Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-2348-2019, datë 30.09.2019.

¹³ Relacion për çështjen me nr. 31003-01537-2019, datë regjistrimi 15.07.2019.

¹⁴ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01909-2016, datë regjistrimi 28.10.2016, relacion për çështjen civile me nr. 11243-04580-00-2014, datë regjistrimi 15.12.2014.

¹⁵ Relacion për çështjen administrative me nr. 31001-04678-2014, datë 23.12.2014.

akteve normative, referuar neneve 17 dhe 119 të Kushtetutës, duke u mbështetur dhe në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 20, datë 11.07.2006¹⁶. Në këtë dokument ligjor, në mendimin e ndihmësit ligjor, ndihmësmagjistrati ka vendosur përballë, duke i përqasur me rrethanat e rastit konkret, çështje të juridiksionit gjyqësor në raport me pasojat e mos përmbushjes së kushteve formale të padisë, në shërbim të argumentit të tij se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gabuar duke vlerësuar çështje të juridiksionit ndërkohë që mos shqyrtimi i çështjes nga organi administrativ, në vlerësim të tij, përbën mos përmbushje të parakushteve për ngritjen e padisë sipas parashikimeve të nenit 16 të ligjit nr. 49/2012.

(ii) Lidhur me nenin 13 pika 3 të Rregullores nr. 78, datë 16.04.2010 të Prokurorit të Përgjithshëm, në mbështetje të çështjes së ngritur për diskutim nëse ky akt më natyre të brendshme, referuar natyrës së akteve normative sipas nenit 119 të Kushtetutës, mund të sjellë ose jo pasoja mbi statusin juridik të magjistratit (prokurorit)¹⁷.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për këtë tregues, vlerësohet edhe aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator. Në lidhje me aftësitë verbale të relatimit sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, ligjit të zbatueshëm dhe/ose konfliktit të normave, pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, në vlerësimin e Kolegjit Administrativ për aftësitë profesionale të ndihmësit ligjor, theksohet ndër të tjera se ai ka shfaqur një përgatitje tepër të lartë teknike–juridike në drejtim të paraqitjes dhe analizimit në mënyrë të saktë të rrethanave të çështjes, vlerësimin e shkaqeve të rekursit, identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm, si edhe elaborimin e qartë të tij, duke referuar edhe qëndrime të jurisprudencës, qoftë në diskutimet me gjyqtarët e Kolegjit, në parashtrimet me shkrim në relacion, apo në hartimin e draftit paraprak të vendimit gjyqësor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes si dhe paraqitjen e tyre në mënyrë të përmbledhur në dokumentet e analizuara. Këto elementë rezultojnë edhe në mënyrën e pasqyrimin të ecurisë procedurale të çështjes në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve pjesët thelbësore të arsyetimit të këtyre gjykatave.

Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në çështjen konkrete, rezulton të jetë bërë në të gjitha dokumenteve ligjore të shqyrtuara, ndërkohë që në disa prej tyre, për shkak të natyrës jo komplekse si dhe diktuar nga natyra krejtësisht procedurale e çështjeve të ngritura në ankim/rekurs, identifikimi dhe referimi i ligjit të zbatueshëm kufizohet vetëm në një ose disa norma procedurale, element ky i diktuar shpesh edhe nga fakti që shkaqet e rekursit është vlerësuar se dukshëm nuk përmbajnë shkaqe si ato të parashikuar në ligj, e për pasojë, është mjaftuar vetëm me citimin e dispozitës procedurale (*nenin 58 të ligjit 49/2012, nenin 443 të K.Pr.C apo nenin 432 të K.Pr.P, sipas rastit*).

¹⁶ *Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-2358-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.*

¹⁷ *Relacion për çështjen administrative nr.31001-04678-2014, datë 23.12.2014.*

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e ndihmësmagjistratit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ÇËSHTJET LIGJORE MATERIALE DHE PROCEDURALE, PËR TË CILAT I KËRKOHET PËRGATITJA E ANALIZËS APO OPINIONIT LIGJOR

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se:

Normat ligjore procedurale dhe materiale relevante për zgjidhjen e çështjes identifikohen dhe sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin, ose interpretohen dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të konkluzionit të arritur nga ndihmësmagjistrati në mbështetje të opinionit të tij mbi zgjidhjen e çështjes apo lidhur me çështjet e ngritura për diskutim para kolegjit në disa raste.

Në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në fuqi në periudhën e vlerësimit, lidhur me detyrat e ndihmësit ligjor, në nenin 34 parashikohet se: *“Pranë Gjykatës së Lartë funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë: a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës; c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari”*.

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr.214, datë 12.09.2014, në fuqi në periudhën e vlerësimit, në nenin 25, pika 1 parashikon se: *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”*

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, interpretimi i ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm në funksion të mbështetjes të opinionit të ndihmësmagjistratit për zgjidhjen e çështjes, paraqet rëndësi, sa i përket përmbushjes në mënyrë cilësore të funksionit të tij ndihmës për Kolegjin, në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete.

Në dokumentet ligjore të analizuar, ka një diferencim mbi mënyrën dhe masën e interpretimit të normave ligjore procedurale ose materiale të evidentuar edhe nga vetë ndihmësmagjistrati në formularin e vetëvlerësimit, në të cilin ai thekson se interpretimi i ligjit të zbatueshëm merrte rëndësi thelbësore në rastet kur vlerësohej se rekursi/ankimi objekt shqyrtimi përmbante shkaqe ligjore. Për këtë arsye, burimet e vlerësimit, për efekt të vlerësimit të këtij treguesi kategorizohen në dy grupe: (i) dokumente ligjore në të cilat ka interpretim të normave ligjore procedurale dhe/ose materiale dhe (ii) dokumente ligjore në të cilat ligji i zbatueshëm referohet por mungon interpretimi i pavarur i dispozitave, pasi

kryesisht veprohet nëpërmjet aplikimit të tyre të drejtpërdrejtë mbi faktin apo rrethanën procedurale konkrete.

Konkretisht, rezulton si më poshtë:

(i) Në relacionin që i takon çështjes administrative nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019, ndihmësmagjistrati interpreton në mënyrë abstrakte dispozitat lidhur me juridiksionin administrativ si parakusht që duhet plotësuar para se paditësi ti drejtohet gjykatës me padi, duke e vendosur atë përballë interpretimit që ai i bën nenit 16, të ligjit nr. 49/2012 që parashikon parakushtet për ngritjen e padisë. Në këtë përballje krahasuese të dispozitave, ndihmësmagjistrati evidenton dallimin midis vendimmarrjes së gjykatës mbi çështje të juridiksionit në raport me vendimmarrjen lidhur me deklarinimin si të papranueshme të padisë, vendimmarrje të cilat sipas tij barazohen në pasoja, por i përkasin fazave të ndryshme të gjykimit dhe diktohen nga shkaqe ligjore të ndryshme. Në mbështetje të qëndrimit të tij lidhur me zgjidhjen e çështjes, si dhe në mbështetje të sugjerimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe evidentimit të çështjeve që duhet të vlerësohen nga Kolegji, ndihmësmagjistrati interpreton në mënyrë sistematike dispozitat e ligjeve të posaçme (nenin 70 të ligjit “Për ushqimin”, nenin 51 të ligjit “Për inspektimin...”, nenet 19 dhe 133 të K.Pr.A). Po ashtu, në mbështetje të argumenteve të tij lidhur me nevojën për vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së aktit nënligjor të zbatueshëm në rastin konkret (VKM nr. 1181, datë 21.10.2009) ndihmësmagjistrati interpreton nenin 17 dhe 119 të Kushtetutës, lidhur me rezervën ligjore, kuptimin e termit “ligj” dhe konceptin e kufizimit të të drejtave dhe lirive “vetëm me ligj”, duke sjellë në mbështetje të argumenteve të tij edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006.

(ii) Në relacionin që i takon çështjes administrative nr. 31003-01043-2016, datë regjistrimi 07.07.2016, ndihmësmagjistrati në mbështetje të mendimit të tij se rekursi përmban shkaqe ligjore, ka referuar dhe interpretuar nenin 193 të K.Pr.C, duke analizuar interesin e ligjshëm për thirrjen e personit të tretë në gjykim, pozitën e tij në proces duke përcaktuar natyrën fakultative dhe jo detyruese për thirrjen e tij, duke argumentuar dhe shtruar për diskutim në këtë kontekst nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me pasojat që sjell për gjykimin, mos thirrja e tij nga gjykata e shkallës së parë.

(iii) Në relacionin që i përket çështjes administrative me nr. 31001-04678-00-2014, datë regjistrimi 23.12.2014, ndihmësmagjistrati referon dhe interpreton nenin 28 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me afatin e procedimit administrativ-disiplinor ndaj prokurorëve si dhe kohën e fillimit të këtij afati. Në këtë kontekst shtrohet për diskutim çështja e vlerësimit në rrugë incidentale të ligjshmërisë së aktit nënligjor (Rregullore nr. 78, datë 16.04.2010 e Prokurorit të Përgjithshëm), duke referuar për natyrën e këtij akti edhe në kuptimin e nenit 119 të Kushtetutës.

(iv) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52810-00798-00-2016, datë regjistrimi 06.05.2016, në mbështetje të argumentit se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore, ndihmësmagjistrati interpreton nenin 59-3 të Kodit të Procedurës Penale, në shërbim të konkluzionit lidhur me pasojat e mosparaqitjes së të dëmtuarit akuzues në procesin e iniciuar prej tij. Po ashtu, në mbështetje të argumentit se vendimi për pushimin e çështje mund të merret ndërkohe që nuk ka përfunduar gjykimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, jep argumente lidhur me natyrën procedurale të vendimit për pushimin e çështjes për shkak të mosparaqitjes së palës akuzuese.

Në katër dokumentet e tjera ligjore, normat ligjore procedurale ose materiale të zbatueshme, referohen dhe zbatohen drejtpërdrejtë në mbështetje të argumentit apo faktit konkret, si dhe konkluzionit lidhur me mungesën e shkaqeve të rekursit/ankimit/kërkesës për rishikim vendimi, duke mos iu nënshkruar një interpretimi të pavarur, diktuar kjo nga natyra jo komplekse e çështjeve. Konkretisht:

(v) *Në relacionin që i takon çështjes administrative me nr. 11243-04580-2014, datë regjistrimi 15.12.2014*, nuk ka interpretim abstrakt të ndonjë norme ligjore të zbatueshme, por analizohet shkaku i rishikimit, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës për rishikim apo afatin prekluziv një vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile, në mbështetje të konkluzionit të arritur se kërkesa është paraqitur jashtë këtij afati, me pasojë mospranimin e saj.

(vi) *Në relacionin që i takon çështjes civile me nr. 31003-01733-00-2015, datë regjistrimi 02.09.2015*, nuk ka interpretim abstrakt të ndonjë norme ligjore të zbatueshme, por jepen konsiderata lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës së apelit për gjykimin e çështjes, duke referuar qëndrimin e mbajtur më parë nga Kolegji Administrativ në vendimin nr. 9, datë 14.01.2014.

(viii) *Në relacionin që i takon çështjes administrative me nr. 31003-01909-00-2016, datë regjistrimi 02.09.2015*, referohen dispozitat procedurale lidhur me shkaqet e rekursit por nuk ka referim apo interpretim të tyre, pasi në rastin konkret mendimi për zgjidhjen e çështjes lidhet me qëndrimin e konsoliduar të praktikës gjyqësore të vetë Gjykatës së Lartë, se ristrukturimi i ndërmarrjes nuk përbën shkak të justifikuar për zgjidhjen e kontratës së punës. Në këtë kontekst, referimi dhe interpretimi i dispozitave të ligjit material ka qenë i panevojshëm.

(ix) *Në relacionin që i takon çështjes administrative me nr. 31003-01537-2019, datë regjistrimi 15.07.2019*, nuk ka interpretim të dispozitave të ligjit procedural ose material të zbatueshëm, por në mbështetje të konkluzionit se rekursi nuk përmban shkaqe të ligjshme, referohet dhe neni 9, pika 3 i ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, në mbështetje të argumentit se pala paditëse nuk ka përlegjur shkakun e ngritur për të justifikuar nevojën e marrjes së masës së sigurimit të padisë.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se pavarësisht se jo gjithmonë janë identifikuar më mënyrë të shprehur, referohen parimi i ligjshmërisë¹⁸, aksesi në gjykatë¹⁹ etj.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, në dokumentet ligjore të analizuara, vërehet kujdesi i ndihmësmagjistratit për të referuar jurisprudencën relevante, (i) duke e referuar atë në mënyrë të përgjithshme në një rast kur ajo përbën qëndrim të konsoliduar lidhur me shkakun e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, pavarësisht se nuk referohen konkretisht vendimet në të cilat është mbajtur ky qëndrim²⁰; (ii) duke referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ në vendimin nr. 9, datë 14.01.2014 lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës administrative në rastet kur padia lidhet me ekzekutimin e një titulli i cili përbën akt administrativ²¹, (iii) referimin në vendimin unifikues nr. 1, datë 26.11.2010 lidhur me juridiksionin e gjykatës, pa shterur ankimin administrativ, në rastet kur

¹⁸ Relacion për çështjen administrative nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019 dhe relacion për çështjen administrative me nr. 31003-04678-00-2014, datë 23.12.2014.

¹⁹ Relacion për çështjen administrative nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019.

²⁰ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01909-00-2016.

²¹ Relacion për çështjen civile me nr. 11243-04582-00-2014.

e drejta e ankimit administrativ nuk parashikohet shprehimisht nga ligji specifik, (vi) Vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të argumenteve të ndihmësmagjistratit lidhur me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit nënligjor në raport me nenin 17 dhe 119 të Kushtetutës. Nëpërmjet referimit të këtij vendimi, ndihmësmagjistrati ka pasuruar argumentet e tij lidhur me konceptim e rezervës ligjore²².

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, në një pjesë të tyre, rezulton të ketë interpretim të dispozitave ligjore procedurale ose materiale që zbatohen në zgjidhjen e çështjes, në mbështetje të argumenteve të dhëna prej tij për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore apo sugjerimit për vlerësimin në rrugë incidentale të kushtetutshmërisë dhe/ose ligjshmërisë së dispozitave të akteve nënligjore të zbatueshme në zgjidhjen e çështjeve. Mungesa e interpretimit abstrakt apo edhe të drejtpërdrejtë mbi faktin në disa prej dokumenteve ligjore të për zgjedhura me short, vjen si rezultat edhe i faktit që në mendimin e ndihmësit ligjor çështja e ardhur për rekurs nuk shtron diskutime ligjore dhe nuk përmban shkaqe ligjore rekursi, e në këtë kontekst, mendimi i ndihmësmagjistratit jepet në mënyrë koncize për mospranimin e rekursit, që korrespondon edhe konkluzionit të relacioneve respektive. Po ashtu, në disa prej dokumenteve ligjore ka referim në praktikën gjyqësore relevante, në mbështetje të opinionit ligjor mbi mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, si dhe në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se pavarësisht se jo gjithmonë janë identifikuar më mënyrë të shprehur, referohen parimet procedurale dhe materiale apo qëndrimi i konsoliduar i praktikës gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs. Ky interpretim evidentohet qartë në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara, ndërsa në pjesën tjetër të tyre, interpretimi i ligjit mungon, për shkak se çështja e ardhur për rekurs nuk shtronte diskutim ligjor.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërit prej tyre.*

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E DOKUMENTIT LIGJOR

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes, në përmbushje të detyrës së

²² Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-2348-2019, datë 30.09.2019.

ndihmësmagjistratit, në funksion të relatimit të qartë, konciz, të plotë dhe lehtësisht të kuptueshëm të çështjes para Kolegjit përkatës së Gjykatës së Lartë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues vlerësohet qartësia, konciziteti, elokuenca dhe lehtësia në kuptimin dhe leximin e dokumenteve ligjore, aftësia për të prezantuar verbalisht çështjen para Kolegjit kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurën e zbatueshme, arsyetimin e gjykatave me të ulëta dhe çështjet e tjera ligjore.

Në rastin konkret, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se gjuha e përdorur nga ndihmësmagjistrati është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore, ato të sintaksës dhe morfologjisë në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte dhe me argumente të cilat renditën në vijueshmëri logjike.

Ndihmësmagjistrati përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e përmbajtjes së dokumentit ligjor janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe nuk krijojnë shkëputje të logjikës së ndërtimit të tyre, brenda së njëjtës nënndarje të dokumentit ligjor, apo në tërësi, duke evidentuar rrjedhshmërinë e mendimit të tij.

Sa i përket paraqitjes së mendimit të ndihmësit ligjor, në 3 prej relacioneve vërehet shkallë e lartë kujdesi për paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësmagjistratit dhe të arsyetimit përkatës në mbështetje të tij. Po ashtu vërehet në disa raste, aftësia e tij për të ngritur çështje ligjore për diskutim dhe për të dhënë argumentet e tij lidhur me mënyrën e zgjidhjes së tyre. Ndërkohë, në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara nuk vërehet e njëjta shkallë kujdesi për paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësmagjistratit dhe të arsyetimit përkatës në mbështetje të tij, pasi mendimi i ndihmësmagjistratit është parashtruar vetëm me dy fjali, pa u shoqëruar me argumente por kjo duket se është diktuar nga fakti që në këto raste, në mendimin e ndihmësit ligjor është konkluduar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk bazohen në ligj, e për pasojë, rekursi nuk duhet të pranohet. Megjithatë edhe në këto raste, në mënyrë të përmbledhur, ndihmësmagjistrati ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me këtë konkluzion, duke mos u kufizuar vetëm në drejtim të konstatimit të këtij fakti.

Sa i përket aftësive të ndihmësmagjistratit për të prezantuar verbalisht çështjet para Kolegjit, nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, por referuar vlerësimit të Kolegjit për aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit, të gjithë komponentët e këtij kriteri janë vlerësuar maksimalisht.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati tregon kujdes të shtuar për pasqyrimin e qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, të ecurisë procedurale të gjykimit, të shkaqeve të rekursit ose të mjetit tjetër ligjor me të cilin është investuar Gjykata e Lartë. Sa i përket paraqitjes së mendimit të ndihmësit ligjor, evidentohet

një shkallë e lartë kujdesi në paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësit ligjor dhe arsyetimit përkatës në mbështetje të tij, pavarësisht se në disa raste pjesa arsyetuese e mendimit është më e kufizuar krahasuar me pjesën tjetër të dokumenteve ligjore, duke u kushtëzohet nga natyra e çështjesh, pasi në disa raste mendimi i ndihmësit ligjor referon në mungesën e shkaqeve të rekursit sipas parashikimeve të ligjit procedural, shoqëruar me paraqitjen në mënyrë të shkurtuar të arsyes mbi të cilën mbështetet ky vlerësim.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E DOKUMENTIT LIGJOR

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se dokumentet ligjore të hartuar nga ndihmësmagjistrati ndjekin përgjithësisht strukturë të njëjtë dhe të standardizuar, duke përmbajtur elementët thelbësorë të relacionit, sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme e Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në fuqi në periudhën e vlerësimit (viti 2019) në nenin 25, pika 1 të së cilës parashikohet se: *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”*

Përmbajtja e dokumenteve ligjore është e organizuar në nënndarje sipas përmbajtjes dhe më tej e ndarë në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin, duke krijuar vijueshmëri në logjikën e paraqitjes së tyre. Përdorimi i titujve (*si rrethanat e çështjet, rekursi, mendimi i ndihmësmagjistratit ose vlerësimi ligjor, dhe konkluzioni*) dhe i pikave referuese, mundëson lexim të organizuar të dokumentit ligjor dhe respektim të strukturës standarde të miratuar, mbi bazën e së cilës hartohet dokumenti ligjor (*relacioni*).

Relacionet e përgatitura nga ndihmësmagjistrati janë të organizuara sipas të njëjtës strukturë, përmbajnë në pjesën hyrëse identifikimin e çështjes, të dhënat e palëve ndërgjyqëse, objektin dhe bazën ligjore të padisë, apo objektin e kërkesës penale ose civile. Përmbajtja e relacioneve është e organizuar në disa pjesë, të identifikuar me titujt përkatës sipas përmbajtjes, si më poshtë: (i) *rrethanat e çështjes*: ku përshkruhen në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi si dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjykatës së apelit; (iii) *rekursi*: ku pasqyrohet ushtrimi i së drejtës së rekursit nga palët, duke renditur në mënyrë të përmbledhur shkaqet thelbësore të rekursit/ankimit të veçantë, ose shkaqet e kërkesës nëpërmjet së cilës është investuar Gjykata e Lartë; (iv) *Vlerësimi ligjor/Mendimi i ndihmësmagjistratit*²³: ku në disa raste referohet ligji i zbatueshëm dhe më pas parashtrohet, nëpërmjet argumenteve ligjore ose në mënyrë të

²³ Ne relacionet e nxjerra nga sistemi përdoret termi “mendimi i ndihmësmagjistratit”, ndërsa në kopjen e atyre të administruar në dosje ose dorëzuar nga ndihmësmagjistrati, kjo pjesë titullohet “vlerësimi ligjor”.

përmbledhur (me disa fjali) mendimi i ndihmësmagjistratit lidhur me paraqitjen e rekursit dhe sugjerimin për zgjidhjen e çështjes si dhe ngrihen kur është rasti çështjet për vlerësim nga Kolegji.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIMIT LOGJIK

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, aftësia për të identifikuar marrëdhënien shkak-pasojë, si dhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen mbi një situatë të caktuar, përmbajtja gjithëpërfshirëse e dokumentit ligjor, si dhe evidentimi i nevojës për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Burimet e vlerësimit, referuar përmbajtjes së pjesës në të cilën pasqyrohet mendimi i ndihmësit ligjor, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteristika të ndryshme dhe ndahen në dy grupe:

Dokumente ligjore në të cilat mendimi i ndihmësmagjistratit parashtrohet në mënyrë të përmbledhur. Konkretisht:

Në 4 (katër) relacione²⁴, konstatohet se mendimi i ndihmësmagjistratit parashtrohet në mënyrë më të përmbledhur, duke u kufizuar vetëm në elementë procedurale që lidhen me vlerësimin e mungesës së shkaqeve ligjore të rekursit ose ankimit, duke u nisur edhe nga natyra jo komplekse dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes, në të cilat është sugjeruar përgjithësisht mospranim rekursi/ankimi. Në këto katër relacione mendimi i ndihmësmagjistratit është pasqyruar në pak fjali të cilat konsistojnë në mendimin se rekursi nuk ngre problem ligjor dhe kushtëzuar nga ky fakt, ndihmësmagjistrati nuk është ndalur në analizë dhe argumentim logjik të zgjeruar në lidhje me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs. Pavarësisht natyrës jo komplekse të tyre dhe konkluzionit për mungesën e shkaqeve ligjore të rekursit, përsëri ka dhënë në mënyrë koncize argumentin e tij lidhur me

²⁴ Relacion për çështjen administrative me nr. 11243-04580-2014, datë 15.12.2014, relacion për çështjen civile nr. 31003-01733-00-2015, datë 02.09.2015, relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01909-00-2016, datë 02.09.2016 dhe relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01537-2019, datë 15.07.2019.

këtë konkluzion, duke u ndalur shkurtimisht në argumentet për paraqitjen e kërkesës për rishikim jashtë afatit prekluziv nga momenti i lindjes së shkakut²⁵; dhënien e mendimit lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës së apelit²⁶; moskonsiderimin e ristrukturimit të ndërmarrjes si shkak i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës²⁷ apo mungesën e një shkakut të përligjur për marrjen e masës së sigurimit të padisë²⁸.

Në 4 (katër) dokumentet e tjera ligjore, në të cilat mendimi i ndihmësit përmban interpretim të ligjit, analizë dhe argumentim logjik, rezulton si më poshtë:

(i) *Në relacionin që i takon çështjes administrative nr. 31003-2348-2019, datë regjistrimi 30.09.2019, është ngritur për diskutim kualifikimi i duhur procedurali situatës së faktit lidhur me paraqitjen e padisë, ndërkohë që ende nuk është shprehur për ankimin administrativ organi më i lartë. Në këtë këndvështrim, duke analizuar në mënyrë sistematike dispozitat ligjore dhe nënligjore të zbatueshme (nenit 16 të ligjit nr. 49/2012, nenin 70 të ligjit “Për ushqimin”, nenin 51 të ligjit “Për inspektimin...”, nenet 19 dhe 133 të K.Pr.A) ndihmësmagjistrati analizon dallimin midis vendimmarrjes së gjykatës mbi çështje të juridiksionit në raport me vendimmarrjen lidhur me deklarin si të papranueshme të padisë, vendimmarrje të cialt sipas tij barazohen në pasoja por i përkasin fazave të ndryshme të gjykimit dhe diktohen nga shkaqe ligjore të ndryshme. Në vijim të këtij argumentimi, i cili vjen si pasojë e interpretimit sistematik të dispozitave logjore të zbatueshme në rastin konkret, ndihmësmagjistrati ka evidentuar çështjet për të cilat sipas tij është e nevojshme që Kolegji të mbaje qëndrimin e tij. Ngjitja e çështjeve për diskutim dhe vlerësim nga kolegji, shoqërohet në këtë rast dhe me argumentimin përkatës të tij, lidhur me këto çështje, duke u ndalur në analizë dhe duke dhënë argumente ligjore sa i përket çështjes së vlerësimit vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së aktit nënligjor të zbatueshëm në rastin konkret (VKM nr. 1181, datë 21.10.2009). Në mbështetje të argumenteve të tij për këtë çështje të ngritur për diskutim, ndihmësmagjistrati ka interpretuar nenin 17 dhe 119 të Kushtetutës, duke dhënë argumente lidhur me rezervën ligjore, kuptimin e termit “ligj” dhe konceptin e kufizimit të të drejtave dhe lirive “vetëm me ligj”, referuar 17 të Kushtetutës, duke sjellë në këtë kontekst edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006. Në tërësi arsyetimi dhe argumentimi ligjor i tij lidhur me çështjet e ngritura për diskutim, është i detajuar dhe i pasuruar me argumente të cilat vijnë në mbështetje të qëndrimit të tij.*

(ii) *Në relacionin që i takon çështjes administrative nr. 31003-01043-2016, datë regjistrimi 07.07.2016, ndihmësmagjistrati ka marrë në analizë pozitën procedurale të personit të tretë në gjykim, duke analizuar natyrën fakultative të thirrjes së tij në proces, pasojat e vendimmarrjes së gjykatës mbi të drejtat dhe interesat e tij, për të konkluduar lidhur me ngritjen e një çështje ligjore që në vlerësimin e tij duket të unifikohet me qëndrimin e Kolegjit, sa i përket pasojave të mos thirrjes së personit të tretë nga gjykata e shkallës së parë. Pavarësisht paraqitjes në mënyrë të përmbledhur të argumenteve, ndihmësmagjistrati, ka ngritur çështje për diskutim dhe ka dhënë argumentin e tij lidhur me zbatimin e nenit 193 të K.Pr.C sa i përket pjesëmarrjes së personit të tretë në gjykim dhe natyrën jo të detyrueshme të kësaj pjesëmarrje.*

²⁵ Relacion për çështjen administrative me nr. 11243-04580-2014, datë 15.12.2014;

²⁶ Relacion për çështjen civile nr. 31003-01733-00-2015, datë 02.09.2015;

²⁷ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01909-00-2016, datë 02.09.2016;

²⁸ Relacion për çështjen administrative me nr. 31003-01537-2019, datë 15.07.2019.

(iii) Në relacionin që i takon çështjes administrative nr. 31001-04678-2014, datë regjistrimi 23.12.2014, në mbështetje të mendimit të tij se rekursi përmbajnë shkaqe të ligjshme, ndihmësmagjistrati ka argumentuar qëndrimin e tij lidhur me momentin e fillimit të afatit të procedimit administrativ, në raport me momentin e konstatimit të shkeljes, duke iu referuar nenit 28 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Argumentet lidhur me këtë çështje të ngritur për diskutim, vijnë edhe me paraqitjet e arsyeve sa i përket çështjes së dytë të ngritur prej tij, lidhur me nevojën për vlerësimin në rrugë incidentale të ligjshmërisë së parashikimeve të aktit nënligjor (Rregullore nr. 78, datë 16.04.2010 të Prokurorit të Përgjithshëm), në këndvështrim edhe të parashikimeve të nenit 119 të Kushtetutës sa i përket natyrës së akteve nënligjore në raport me aktet e brendshme sikurse vlerësohet të jetë rregullorja.

(iv) Në relacionin që i takon çështjes penale nr. 52810-00798-2016, datë regjistrimi 06.05.2016, në mbështetje të mendimit se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore, ndihmësmagjistrati interpreton nenin 59/3 të K.Pr.P dhe jep argumente lidhur me pasojat ligjore të mosparaqitjes në gjykim, pa shkaqe të përligjura, të të dëmtuarit akuzues. Gjithashtu, jep argumente lidhur me natyrën procedurale të vendimit të pushimit në këtë rast, në raport me pretendimin e palës për dhënien e këtij vendimi para se të shprehej gjykata lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit.

Në tërësi, në dokumentet ligjore si më sipër, rezulton se ndihmësmagjistrati ka treguar kujdes në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me pretendimet e ngritura nga palët në rekurs/ankim/kërkesë, duke i analizuar ato në disa raste në mënyrë të përmbledhur dhe në formën e një konkluzioni dhe në disa raste të tjera të cilat paraqiten më komplekse, në mënyrë më të detajuar, logjike, të kuptueshme dhe duke ndërthurur në to interpretimin ligjor të dispozitave të zbatueshme. Analiza e fakteve thelbësore apo çështjeve ligjore që janë bërë objekt rekursi, bëhet në disa raste duke integruar analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, në shërbim të konkluzionit të paraqitur që në pjesën hyrëse të mendimit të ndihmësit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjes, dhe në disa raste të tjera në mbështetje të çështjeve të ngritura për diskutim para Kolegjit.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve në rekurs/ankim, në dokumentet e analizuara, evidentohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të veçuar dhe përmbledhur shkaqet thelbësore të rekursit/ankimit/kërkesës, si dhe për të veçuar dhe analizuar kur është rasti, ato fakte apo pretendime që kanë rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes apo në funksion të evidentimit të çështjeve të ngritura për diskutim prej tij, të cilat në çdo rast shoqërohen edhe me mendimin e argumentuar të tij mbi qëndrimin që duhet të mbahet për këto çështje.

Referuar Rregullores së Gjykatës së Lartë, në fuqi në periudhën e vlerësimit, ndihmësmagjistrati që ushtronte veprimtarinë pranë Kolegjit Administrativ, nëse i kërkohej, hartonte edhe projektvendimin, fakt që përmendet edhe në mendimin e Kolegjit dhe të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, e që merret parasysh në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi. Sipas Kolegjit të Gjykatës së Lartë, ndihmësmagjistrati {...} gjatë ushtrimit të detyrës ka spikatur për identifikimin e qartë të marrëdhënies juridike objekt shqyrtimi, duke bërë një cilësim juridik të drejtë të fakteve nëpërmjet identifikimit dhe aplikimit të saktë të instituteve juridike apo dispozitave ligjore që shërbejnë për përshkrimin e fakteve dhe dhënie

përgjigje të përshtatshme dhe tërësore çështjeve juridike të ngritura nga palët në recurs. Në vlerësimin e Kolegjit evidentohet kontributi i ndihmësmagjistratit në përgatitjen e projekt-vendimeve gjyqësore për çështjet e relatuar, referuar akteve të vlerësimin të Kolegjit në të cilat kjo aftësi vlerësohet maksimalisht dhe për pasojë do të konsiderohet në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

Në tërësi, edhe pse në dokumentet ligjore të analizuar, nuk evidentohet e njëjta shkallë analize dhe argumentimi logjik, pasi në disa prej tyre komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, por duke u shoqëruar me një analizë të shkurtër se pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor, kjo rezulton të jetë kushtëzuar nga natyra jo komplekse e çështjeve konkrete për të cilat konkludohet për mungesën e shkaqeve ligjore të recursit/ankimit. Në dokumentet e tjera të analizuar, rezulton e qartë aftësia e ndihmësmagjistratit për të analizuar qartë dhe mbështetur në argumente ligjore dhe logjike, çështjet e shtruar për diskutim, duke veçuar në dy raste edhe argumentet e tij lidhur me nevojën e vlerësimin në rrugë incidentale të ligjshmërisë së akteve nënligjore përkatëse, dhe në një rast çështjen e ngritur për unifikimin e qëndrimit të Kolegjit lidhur me pjesëmarrjen e personit të tretë në gjykim. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistratit, e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së ndihmësmagjistratit, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues duhet të vlerësohet “*Shumë e lartë*”.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimin, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*” vlerësohet “*Shumë të lartë*”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

| Niveli i vlerësimin | |
|--|-------|
| AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT | |
| Niveli i vlerësimin | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e tij për të ndihmuar dhe kontribuar në mënyrë efektive në menaxhimin e çështjeve, nëpërmjet menaxhimit të kohës, planifikimin e çështjeve që ai përgatit për shqyrtim si dhe veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në Kolegj. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë ndihmësmagjistrati përdor kohën e tij në funksion të shqyrtimit të çështjeve nga Kolegji. Kjo aftësi vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. TREGUESI SASIOR NË PËRFUNDIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit vitit 2019, rezulton se ndihmësmagjistrati {...} ka përgatitur për relativitet 76 çështje të kategorisë “rekurs”, në pritje të gjykimit nga Kolegji Administrativ, 2 çështje të kategorisë “rekurs”, të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal, 138 çështje të kategorisë “rekurs” të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal, 1 çështje të kategorisë “kërkesa të tjera”, në pritje të gjykimit nga Kolegji Administrativ. Sa më sipër, rezulton se ndihmësmagjistrati {...} ka përgatitur për relativitet 216 çështje themeli në vitin 2019 (duke hequr çështjen e kategorisë “kërkesë”), ose rreth 20 çështje themeli në muaj, duke përjashtuar këtu muajin gusht në të cilin zhvillohet leja vjetore e gjykatës. Ndërkohë, referuar statistikave dhe të dhënave të dërguara nëpërmjet komunikimit me e-mail me Gjykatën e Lartë, rezulton se ka përgatitur për relativitet edhe 50 çështje të kategorisë “kërkesa të tjera”, pra jo çështje themeli, si dhe ka relatuar 39 çështje lidhur me praktika për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe revokim të vendimit të pezullimit, të cilat nuk janë materializuar në relacione dhe për këtë shkak nuk janë përfshirë në tabelat me të dhëna statistikore.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se ndihmësmagjistrati {...} ka përgatitur për relativitet gjithsej 216 çështje themeli, ose rreth 20 çështje në muaj, në standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh në muaj,²⁹ treguesi i cili rezulton “Në standard”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, deri në pikëzim maksimal. Referuar këtij parashikimi, duke marrë në konsideratë:

- (i) Vlerësimin e Kryetarit dhe Kolegjit të Gjykatës së Lartë, i cili lidhur me treguesin sasior të punës ka konkluduar se aftësitë e ndihmësmagjistratit janë tepër të larta;
- (ii) Volumin e çështjeve të tjera të përgatitura nga ndihmësmagjistrati, të cilat nuk janë pjesë e të dhënave statistikore, por janë referuar nga Gjykata e Lartë, referuar vlerësimit të Kolegjit, (për vitin 2019 rezulton që ndihmësmagjistrati {...} Pëllumbu ka përfunduar edhe relacionet për 51 çështje të kategorisë “kërkesa të tjera” si dhe 39 relatime për praktikën e pezullimeve dhe të revokimeve relacione të cilat nuk janë të pasqyruara fizikisht në dosje),

vlerësoj se pikëzimi për këtë tregues duhet të bëhet në një nivel më të lartë, nga ai “në standard”, në nivelin “mbi standard”.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e ndihmësmagjistratit për këtë tregues vlerësohet “Mbi standard”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

²⁹Referuar standardit sasior në fuqi në periudhën e vlerësimit (rregullore e miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë), ndihmësmagjistratit duhet t'i jenë caktuar për trajtim (relativitet) së paku 20 çështje në muaj

2.A.B. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE

Në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara për relativitetin për periudhën e vlerësimit, por gjenerohen vetëm të dhënat në lidhje me relacionet e përgatitura gjatë periudhës së vlerësimit për ndihmësmagjistratin. Në këtë kontekst, duke qenë se rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore përlogaritet nga raporti midis çështjeve të përgatitura për shqyrtim (*të përfunduara + të papërfunduara me vendim*), pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve të caktuara për relativitetin brenda një viti kalendarik, llogaritja e rendimentit të përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit është objektive dhe pamundur. Nga ana tjetër, duhet mbajtur në konsideratë fakti se ndihmësmagjistrati ka përgatitur për relativitetin gjithsej 267 relacione (rekurs + kërkesa të tjera) për të gjithë periudhën e vlerësimit, ose 24 relacione në muaj, duke tejkaluar në këtë mënyrë edhe standardin e vendosur prej 20 çështje në muaj. Gjithashtu, sipas të dhënave të dërguara nga Gjykata e Lartë, në lidhje me statistikat e ndihmësmagjistratit {...} për vitin 2019, rezultoi që ka përfunduar edhe 39 relacione për praktikantët e pezullimeve dhe të revokimeve, relacione të cilat nuk janë të pasqyruara fizikisht në dosje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga analiza logjike e të gjithë ngarkesës së punës së ndihmësmagjistratit, vlerësoj se është rasti për të zbatuar nivelin maksimal të pikëzimit, bazuar edhe në vlerësimin që vetë Kolegji dhe Kryetari i ka bërë efikasitetit dhe shpejtësisë në trajtimin e çështjeve nga ana e ndihmësmagjistratit, si dhe angazhimit të tij në detyra të tjera të caktuara nga Kryetari, të evidentuara në vlerësimin e Kolegjit, sipas të cilit ndihmësmagjistrati ka treguar aftësi të një shkalle të lartë në realizimin e ngarkesës vjetore (*relacione, projektvendime*). Bazuar në këtë analizë logjike, referuar kushteve të punës e shkallës së angazhimit të ndihmësmagjistratit në detyra të tjera, veç atyre të trajtimit të çështjeve gjyqësore, vlerësohet se pikëzimi për këtë tregues duhet të jetë në nivel maksimal.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, se aftësia e ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore” rezultoi “+99%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA PËR TË PËRFUNDUAR NË KOHË ÇËSHTJET E NGARKUARA

2.B.A. RESPEKTIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përgatitur dokumentin ligjor brenda standardit minimal kohor të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh, si raport mes numrit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit, me numrin total të çështjeve të përgatitura.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore të administruara në dosje, nuk rezultojnë të dhëna për të mundësuar përlogaritjen e kohës së përgatitjes së dokumenteve ligjore, pavarësisht faktit që në tabelat statistikore data e relacionit është e përcaktuar, por që prezumohet të mos jetë data e saktë e relacionit, përse kohë që gjithmonë kjo datë përkon me datën e vendimit të Kolegjit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton që kuadri ligjor dhe nënligjor, të kishte të përcaktuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor.

Dokumentet ligjore të përzgjedhura me short (*relacionet e nxjerra nga sistemi i Gjykatës së lartë, pasi në 5 nga 6 dosje nuk rezulton që të jetë relacioni i ndihmësmagjistratit*) nuk përmbajnë datën e hartimit të tyre. Gjithashtu, aktet e dosjeve për këto çështje nuk përmbajnë asnjë të dhënë për datën e caktimit dhe datën e përfundimit të dokumentit ligjor (*relacionit*) nga ana e ndihmësmagjistratit.

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë,³⁰ në nenin 15 pika, 1 dhe 2 parashikojnë se: “1. Mbledhja e kolegjit në dhomë këshillimi për shqyrtimin e rekursit zhvillohet në datat e caktuara nga kryetari i Kolegjit, pas konsultimit në anëtarët e tjerë të Kolegjit respektiv. 2. Ndhimësi ligjor i gjyqtarit relator duhet të ketë shpërndarë më parë për studim relacionin dhe materialet e tjera ndihmëse...”.

Referuar këtij parashikimi, në mungesë të të dhënave për datën e caktimit të çështjes ndihmësmagjistratit për përgatitjen e relacionit dhe për datën e përfundimit të tij, koha e përgatitjes si rregull mund të përlogaritet duke konsideruar si datë të caktimit të çështjes, datën e vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi dhe si datë të përfundimit të tij, datën e zhvillimit të seancës së parë, në të cilën gjyqtari relator ka relatuar çështjen. Në këtë rast prezumohet se relacioni është përgatitur nga ndihmësmagjistrati para datës së relatimit të tij para Kolegjit.

Nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, sa i përket kohëzgjatjes së përgatitjes së relacionit, duke iu referuar arsyetimit si më sipër, rezulton se:

- i) Çështja me nr. 31003-**04678**-2014 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2021-3, datë 11.01.2021, të Kolegjit Administrativ, është vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi në datën 18.12.2020 dhe ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, në datën 11.01.2021. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit rezulton të jetë 24 ditë, por kjo kohë nuk mund të përbëjë kohë të përgatitjes së relacionit pasi gjyqtari {...}, sipas tabelave me të dhëna statistikore rezulton se ka përfunduar përgatitjen e dokumentit ligjor gjatë vitit 2019.*
- ii) Çështja me nr. 31003-**001909**-2016 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2019-307, datë 30.04.2019, të Kolegjit Administrativ, është vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi në datën 04.04.2019 dhe ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, në datën 30.04.2019. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit rezulton të jetë 26 ditë. Koha e përgatitjes së relacionit vlerësohet të jetë më e shkurtër se 26 ditë.*
- iii) Çështja me nr. 11243-**04580**-2014 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2020-264, datë 27.07.2020, të Kolegjit Administrativ, është vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit

³⁰Rregullore e miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi në datën 03.07.2020 dhe ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, në datën 27.07.2020. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit rezulton të jetë 24 ditë. Por kjo kohë nuk mund të përbëjë kohë të përgatitjes së relacionit pasi gjyqtari {...}, sipas tabelave me të dhëna statistikore rezulton se ka përfunduar përgatitjen e dokumentit ligjor gjatë vitit 2019.*

- iv) Çështja me nr. 52810-**00798**-020-2016 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2019-6, datë 13.02.2019, të Kolegjit Penal, nuk ka vendim të relatorit për caktimin e seancës në dhomë këshillimi, dhe për pasojë, nuk mund të përcaktohet koha momenti i vënies në lëvizje të saj deri në momentin e përfundimit të çështjes, duke pamundësuar përcaktimin e kohës së përgatitjes së relacionit nga ndihmësmagjistrati.
- v) Çështja me nr. 31003-**01537**-002019 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2020-948, datë 14.12.2020, të Kolegjit Administrativ, nuk ka në dosje vendim të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi dhe për pasojë, nuk mund të përcaktohet koha momenti i vënies në lëvizje të saj deri në momentin e përfundimit të çështjes, duke pamundësuar përcaktimin e kohës së përgatitjes së relacionit nga ndihmësmagjistrati. *Sipas tabelave me të dhëna statistikore rezulton përgatitja e relacionit ka përfunduar përgatitjen e dokumentit ligjor gjatë vitit 2019.*
- vi) Çështja me nr. 31003-01733-2015 akti, përfunduar me vendimin nr. 00-2020-786, datë 26.10.2020, të Kolegjit Administrativ, është vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit të gjyqtarit relator për caktimin e seancës në dhomë këshillimi në datën 05.10.2020 dhe ka përfunduar nëpërmjet marrjes së vendimit, pas relatimit, në datën 26.10.2020. *Koha nga momenti i vënies në lëvizje të çështjes deri në datën e relatimit rezulton të jetë 21 ditë, por kjo kohë nuk mund të përbëjë kohë të përgatitjes së relacionit pasi gjyqtari {...}, sipas tabelave me të dhëna statistikore rezulton se ka përfunduar përgatitjen e dokumentit ligjor gjatë vitit 2019.*

Në tërësi për 6 (gjashtë) çështjet e analizuara, vetëm për 1 prej tyre ka të dhëna për mundësuar përllogaritjen e kohës së mundshme të përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, i cili vlerësohet të jetë përgatitur për një kohë më të shkurtër se 26 ditë. Për 5 çështjet e tjera koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përllogaritet për shkak se relacionet rezultojnë të përfunduara në një kohë shumë më të hershme se sa koha e vënies në lëvizje të çështjes nga gjyqtari relator dhe përfundimit të gjykimit të saj. Bazuar në sa më sipër, duke konsideruar vlerësimin e Kolegjit dhe Kryetarit lidhur me efikasitetin në punë të ndihmësmagjistratit, si dhe në mungesës së të dhënave të sakta për të përllogaritur kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, për ndihmësmagjistratin {...}, vlerësohet se aftësia e tij për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistratit për këtë tregues, duhet të pikëzohet maksimalisht me 15 pikë.*

2.B.B. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE TË PËRGATITUR PËR RELATIM

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi përlllogaritet koha mesatare që i dedikohet përpunimit të dokumenteve ligjore për çdo çështje, krahasuar me standardet kohore të përcaktuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për çdo kategori çështjesh.

Referuar të dhënave statistikore, si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, për përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje sipas kategorive, evidentohen disa elementë që pamundësojnë përlllogaritjen e saktë të kohës mesatare, si më poshtë:

- Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk rezultojnë standarde kohore të miratuara për përgatitjen e dokumentit ligjor për kategori çështjesh dhe as për çështjet në tërësi;
- Të dhënat statistikore të administruara edhe pse i diferencojnë çështjet në kategori, rezultojnë që koha e përgatitjes së relacionit mban të njëjtën datë me datën e vendimit të Kolegjit;
- Të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short nuk mundësojnë përlllogaritjen e saktë të kohës mesatare të përgatitjes së dokumentit ligjor për çdo kategori çështjesh.

Referuar çështjeve për të cilat mund të përlllogaritet koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor (*relacionit*) nga ndihmësi ligjor, duke konsideruar si kohë të përgatitjes së tij momentin nga data e vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi nga gjyqtari relator, deri në datën e relatimit të çështjes, rezultojnë se:

- i) Koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategorinë e çështjeve me objekt “Rekurs” është rreth 24 ditë (4 çështje);
- ii) Koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategorinë e çështjeve me objekt “Kërkesa të tjera” nuk mund të përcaktohet pasi në dosjen e 1 çështje të përzgjedhur me short nga kjo kategori nuk ka vendim të gjyqtarit relator për caktimin e seancës për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar kohës mesatare të përgatitjes së relacionit për 5(pesë) çështjet për të cilat ka të dhëna, ajo rezultojnë të jetë 24 ditë. Në mungesë të të dhënave të sakta për të përlllogaritur kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, si dhe vlerësimit maksimal të Kolegjit Administrativ dhe Kryetarit lidhur me treguesin e shpejtësisë së për ndihmësmagjistratin {...}, vlerësohet se aftësia e tij për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relativ”, vlerësohet se ndihmësmagjistrati duhet të pikëzohet me 20 pikë.

2.C. METODOLOGJIA E PUNËS

2.C.A AFTËSIA PËR TË EVINDETUAR E KRYER VEPRIMET E NEVOJSHME DHE SHMANGIEN E VEPRIMEVE JOPRODUKTIVE NË FUNKSION TË ORGANIZIMIT TË PROCESIT GJYQËSOR

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se:

Nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim nuk rezultojnë të dhëna konkrete lidhur me ndihmën dhe kontributin e ndihmësit ligjor sa i përket respektimit të rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore, respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator ose Kolegji, kryerjen e veprimeve efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës, planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, kryerjen në kohë të njoftimeve/shpalljeve, dokumentimin e vendimeve ose të veprimeve të tjera procedurale, ndjekjen e seancave apo diskutimeve për çështjet, si dhe ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve.

Në dosjet gjyqësore të cilat i përkasin çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nga 6 (gjashtë) çështje, në asnjë prej tyre nuk administrohen dosjet e plota të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjet. Në dosjet e administruara nuk rezultojnë të jenë bërë pjesë njoftimet apo shpalljet e bëra në lidhje me çështjet. Po ashtu, në procesverbalet e seancave të zhvilluara në dhomë këshillimi nuk pasqyrohet prezenca ose jo e ndihmësit ligjor gjatë relatimit të çështjes para Kolegjit, por në formularin e mendimit të Kolegjit theksohet aftësia e ndihmësmagjistratit në gjithë procesin e trajtimit të çështjeve si dhe respektimin e fateve procedurale me natyrë ligjore ose administrative gjatë këtij procesi. Po ashtu theksohet se ndihmësmagjistrati ka ndjekur me përpikmëri rendin kronologjik në trajtimin e çështjeve si dhe ka trajtuar dhe relatuar me profesionalizëm.

Nga vëzhgimi i 6 (gjashtë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim rezulton se seancat e planifikuara janë zhvilluar në datën e planifikuar dhe gjykimi ka përfunduar në një seancë, duke mos dështuar asnjë seancë për shkak të moskryerjes së njoftimeve/shpalljeve. Ky element në mënyrë të tërthortë tregon se ndihmësmagjistrati ka kontribuar në mënyrë efektive për kryerjen e njoftimeve/shpalljeve në kohë dhe me efektivitet.

Në mungesë të të dhënave konkrete lidhur me aspektet që shërbejnë për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme procedurale dhe shmangien e veprimeve joproductive, në funksion të organizimit të procesit gjyqësor, si dhe duke u bazuar në mendimin e Kolegjit Administrativ i cili i ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete dhe të plota lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësmagjistrati në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësoj se aftësitë e ndihmësmagjistratit për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet të pikëzohen maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproductive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.C.B AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR BRENDA ÇËSHTJEVE TË CAKTUARA PËR RELATIM, ATO QË KËRKOJNË VËMËNDJE TË POSAÇME DHE QË DUHET TË TRAJTOHEN ME PËRPARËSI, PËR SHKAK TË KËRKESAVE PROCEDURALE

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik rezultojnë se:

Nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, asnjë prej tyre është çështje e cila duhet të trajtohet me përparësi për shkak të afatit ligjor të shqyrtimit.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezultojnë se ndihmësmagjistrati ka trajtuar dhe përgatitur për relativitet³⁹ çështje në lidhje me kërkesa për pezullim në çështje civile dhe penale apo revokime, të cilat sipas nenit 479³¹ të K.Pr.Civile dhe nenit 417³² të K.Pr.Penale përbëjnë çështje të cilat shqyrtohen me prioritet.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit sa i përket aspekteve për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar çështjet që kërkojnë vëmendje të posaçme, si dhe duke konsideruar vlerësimin e Kolegjit Administrativ i cili ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi, vlerësimit të Kolegjit dhe Kryetarit, mungesës së të dhënave për çështje konkrete të cilat përbëjnë çështje me përparësi në trajtim, si dhe të dhënave për numrin e kërkesave për pezullim të trajtuar nga ndihmësmagjistrati gjatë periudhës së vlerësimit, prezumohet se ai ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relativitet të të gjitha çështjeve të kësaj natyre. Për këtë arsye, vlerësoj se aftësitë e tij për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet të pikëzohen maksimalisht.

³¹Nenin 479 i K.Pr.Civile, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017 parashikonte: “Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin kur : a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme. b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”

³²Neni 417 i K.Pr.Penale, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, parashikonte: “Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit ose të kërkesës për rishikim, vendimi mund të pezullohet me urdhër, përkatësisht, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor.”

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.C.C. RREGULLSHMËRIA, SAKTËSIA E PLOTËSIA E DOSJES GJYQËSORE

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se:

Për 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, aktet e dosjes janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik, duke ndjekur përgjithësisht këtë rregull: vendimi për caktimin e seancës në dhomë këshillimi; procesverbalet për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi sipas datave; vendim i Kolegjit Administrativ apo Penal. Në disa raste, pjesë e fashikullit është bërë edhe rekursi i paraqitur nga palët, i cili është renditur para vendimit për caktimin e seancës. Nuk evidentohet përfshirja në dosje e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, por në 5 nga 6 dosjet e administruara, evidentohet mungesa e relacionit të përgatitur nga ndihmësmagjistrati. Të gjitha dosjet e administruara paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të renditura në mënyrë kronologjike dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë në çdo rast të rregullta dhe të sakta, por jo në çdo rast janë të plota, pasi në 5 nga 6 dosjet e përzgjedhura me short mungon dokumenti ligjor (*relacioni*) i përgatitur nga ndihmësmagjistrati. Referuar Metodologjisë për këtë tregues, vlerësohet shkalla e kujdesit të treguar nga ndihmësmagjistrati jo vetëm për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, por edhe shkalla e kujdesit e mbikëqyrja e procesit administruar të dokumentacionit në dosje, duke i dorëzuar aktet e përgatitura prej tij. Për këtë arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues është “Mbi mesataren”.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në këtë tregues, duke konsideruar mungesën e dokumentit ligjor të përgatitur prej tij (relacionit) në 6 dosjet e vëzhguara, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

| Niveli i vlerësimit | Pikët |
|---------------------|-------|
| Shkëlqyeshëm | 98 |

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, pavarësisht institucionit ku kontribuon, është së pari gjyqtar dhe për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo ndihmësmagjistrat e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për ndihmësmagjistratin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2790/1Prot., datë 17.06.2021, ka informuar Këshillin se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarit {...} është depozituar një ankesë e shtetas L.Z, depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 2368 Prot., datë 24.04.2019 dhe riregjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1086 Prot., datë 10.06.2020.

Referuar përmbajtjes së vendimit të ILD-së për trajtimin e ankesës, rezulton se pretendimet e ankueses konsistojnë në mënyrën e vlerësimit të provave dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, në një çështje të përfunduar nga gjyqtari, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjatë shqyrtimit të ankesës, ka rezultuar se vendimmarrja e gjyqtarit ishte bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit Vlorë e cila kishte konfirmuar vendimmarrjen e tij.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka disponuar me vendimin nr. 10863/4Prot., datë 28.12.2020, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja L.Z”, me arsyetimin se pretendimet a ankuesit konsistojnë mbi themelin e vendimmarrjes së gjykatës, të cilat janë objekt shqyrtimi nëpërmjet mjeteve të ankimit.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimin e ILD, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në proces, mungesë vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, ka

reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, vlerësohet shkalla “Shumë e lartë” e aftësisë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, ndaj gjyqtarit {...}, rezulton të jetë paraqitur 1 (një) ankesë e cila pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr.0863/4Prot., datë 28.12.2020, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja L.Z”, me arsyetimin se pretendimet a ankuesit konsistojnë mbi themelin e vendimmarrjes së gjykatës, të cilat janë objekt shqyrtimi nëpërmjet mjeteve të ankimit. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, për gjyqtarin {...} nuk është dhënë asnjë e tillë.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 205/23Prot., datë 21.10.2021, konkludohet se (a) deklarami është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (d) nuk ka kryer deklaram të rremë; (e) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistratit.

Shkalla e integritetit të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” ndihmësmagjistrati ka shfaqur shkallë “Shumë të lartë” integriteti, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se:

Në dy dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati dhe aktet e 6 (gjashtë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në përmbajtje të dokumenteve ligjore (*relacione*) të tij.

Po ashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese në komunikimin me kolegët, administratën gjyqësore, gjyqtarët, apo subjekte të tjera.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga ndihmësmagjistrati.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose në përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE PËR HEQJE DORË TË REFUZUARA NGA KRYETARI

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton që ndihmësmagjistrati {...} për periudhën e vlerësimit të ketë dhënë dorëheqjen nga ndonjë çështje, e për me tepër, të jetë refuzuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 2 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga ndihmësmagjistrati) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga trajtimi i çështjes.

Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se nga të dhënat burim vlerësimi rezulton se nuk ka asnjë kërkesë të paraqitur për heqje dorë nga përgatitja e dokumenteve ligjore për çështjet e caktuara, e për rrjedhojë, asnjë kërkesë të refuzuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari” ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

| Niveli i vlerësimit | |
|--|-------|
| ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE | |
| Niveli i vlerësimit | Pikët |

| | |
|--------------|-----|
| | |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A. AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në Raportin Analitik, rezulton se ndihmësmagjistrati, në dokumentet e hartuara prej tij, është shprehur në mënyrë të qartë, transparente, të saktë, koncize dhe të drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e shkrimit ligjor. Referuar formularit të mendimit të Kryetarit dhe Kolegjit, rezulton se ndihmësmagjistrati ka shfaqur aftësi shumë të mira të komunikimit dhe mendimit nëpërmjet përdorimit të një gjuhe juridike të artikuluar qartë, të kuptueshme si në aktet e hartuara prej tij ashtu edhe në diskutimet në dhomë këshillimi.

Po ashtu, rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të tij gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësmagjistratit në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar, apo me të tretët.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej tij.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektimin të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se ndihmësmagjistrati ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga ndihmësmagjistrati dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

4.B.A. GATISHMËRIA DHE SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të ndihmësmagjistratit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Ndihmësmagjistrati dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivelin maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës profesionale, diskutime dhe propozime për përmirësimin e proceseve të punës së Gjykatës së Lartë, si dhe është karakterizuar nga një frymë e lartë bashkëpunimi për arritjen e objektivave të përbashkëta.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.B.B GATISHMËRIA DHE KONTRIBUTI PËR TË KRYER DETYRA TË TJERA QË I NGARKOHEN NGA ORGANET DREJTUESE TË GJYKATËS

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit.

Referuar formularit të mendimit të kryetarit, rezulton se aftësia e ndihmësmagjistratit {...} për të kontribuar në kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga organet drejtuese të gjykatës është vlerësuar e lartë, duke theksuar se ndihmësmagjistrati ka demonstruar gjithmonë gatishmëri dhe përkushtim në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga Kryetari i Gjykatës. Ai ka qenë në grupin e punës për rishikimin e legjislacionit për gjykimet në Gjykatën e Lartë, posaçërisht për pjesën e gjykimeve në Gjykatën e Lartë, si dhe në grupin e punës për përmirësimin e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Në kushtet kur rezulton angazhimi i ndihmësmagjistratit në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, veç kontributit të tij në lidhje me trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe kryerjen e detyrave thelbësore të ndihmësmagjistratit, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistratit në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, vlerësohet se aftësia e tij në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës”, duke qenë se rezulton angazhimi dhe kontributi i tij konkret, ndihmësmagjistrati duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

4.B.C AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR DHE PËR TË REAGUAR ME EFIKASITET NË RAST NEVOJE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe të bashkëpunimit të ndihmësmagjistratit me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore, ndërkohë që ndihmësmagjistrati dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se ndihmësmagjistrati gjatë ushtrimit të detyrës, ka arritur të vendosë një dialog dhe ballafaqim të vazhdueshëm dhe efikas me gjyqtarët, që ka rezultuar i dobishëm për veprimtarinë vendimmarrëse të Gjykatës së Lartë, si dhe të krijojë profilin e një personi korrekt dhe bashkëpunues me kancelarin dhe administratën gjyqësore, i qetë, me aftësinë për të përballuar me sukses vështirësitë që kanë rezultuar dhe impenjimet e ndërmarra për zgjidhjen e tyre.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë” shkalla e aftësisë është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

4.C GATISHMËRIA PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA

4.C.A. PJESËMARRJA NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se ndihmësmagjistrati {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019 ka marrë pjesë në programin e Trajnimit Vazhdues:

- (i) në 2 (dy) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluara në 3 ditë; në cilësinë e pjesëmarrësit dhe
- (ii) në 9 (nëntë) aktivitete trajnuese, në cilësinë e lehtësuesit, konvertuar në numër ditësh, 32 (tridhjetë e dy) ditë.³³

Gjithashtu, rezulton se ndihmësmagjistrati {...} ka marrë pjesë në një aktivitet të formimit profesional (*trajnim*), jashtë programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

Trajnimi me temë “*Shteti i së drejtës. Pavarësia dhe llogaridhënia e pushtetit gjyqësor si dhe mbrojtja efektive gjyqësore.*”, zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, në datat 26 dhe 27 shkurt 2019.

Sa më sipër, rezulton se ndihmësmagjistrati ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet të formimit profesional të llojit trajnim, jashtë programit të Formimit Vazhdues.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistrati ka marrë pjesë në 12 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 37 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë, sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit nr.96/2015, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

***Pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufirit 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019), duke e pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E NDIHMËSMAGJISTRATIT PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se ndihmësmagjistrati {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 9 (nëntë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e lehtësuesit, aktivitete të zhvilluara në datat 16 dhe 17 janar, 18 janar, 11 dhe 12 mars, 8 dhe 9 maj, 28 qershor, 8 dhe 9 korrik, 20 dhe 21 nëntor dhe 18 dhe 19 dhjetor 2019.

³³Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

Bazuar në sa parashtrohet me sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistratin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e lehtësuesit në 9 (nëntë) aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve” ndihmësmagjistrati pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij.

4.C.C PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...} gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë, gjatë vitit 2019, është angazhuar në cilësinë e pedagogut të jashtëm pranë Univesitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në lëndën “E drejta administrative e posaçme”³⁴.

Në Formularin e vetëvlerësimit, ndihmësmagjistrati ka renditur lidhur me këtë tregues edhe referimin me temë “Risitë e Kodit Civil të vitit 1929 në institutet e të drejtës familjare”, referat i mbajtur në Simpoziumin me temë “90 vjetori i Kodit të Parë Civil Shqiptar 1929). Përfaqse historike dhe aktuale. Baltasar Benussi, themeluesi i doktrinës të së drejtës civile në Shqipëri”, organizuar nga Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, 9 maj 2019.

Kryetari i Gjykatës, lidhur me këtë tregues, referon se ndihmësmagjistrati {...} ka dhënë kontribut të rëndësishëm në hartimin e legjislacionit, kryesisht lidhur me ndryshimet e fundit në kodet e procedurave në vitin 2021 si dhe ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare si përfaqësues i Gjykatës së Lartë. Për këto veprimtari kryetari nuk ka përcaktuar konkretisht angazhimin e gjyqtarit dhe kohën e angazhimit të tij, për të vlerësuar nëse ajo përfshihet në periudhën e vlerësimit.

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike, e cila duhet të synojë përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

³⁴Shih vërtetimin me nr. 820 prot., datë 24.04.2020, dërguar nga gjyqtari nëpërmjet postës elektronike.

Prandaj angazhimi i gjyqtarit në cilësinë e pedagogut të jashtëm dhe referimi i tij në një simpozium shkencor, janë tregues i përpjekjeve të vazhdueshme të gjyqtarit për të dhënë kontribut në përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, referuar shtrirjes së angazhimit dhe shkallës së pjesëmarrjes, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Pjesëmarrja, kontributi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i ndihmësmagjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë”, ndihmësmagjistrati pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi i tij në disa aktivitete të kësaj natyre.*

4.C.Ç PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqaruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e ndihmësmagjistratit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjatë vitit 2019 ndihmësmagjistrati ka publikuar artikuj apo botime shkencore si më poshtë:³⁵

- (i) “Kontrolli gjyqësor mbi aktin nënligjor normativ”, Revista Avokatia nr. 32, viti 2019, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- (ii) “Probleme juridike të parashkrimit fitues me titull”, Revista Avokatia nr. 30, viti 2019, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

Në Formularin e vetëvlerësimit, ndihmësmagjistrati ka renditur në këtë tregues edhe referimin me temë “Risitë e Kodit Civil të vitit 1929 në institutet e të drejtës familjare”, referat i mbajtur në Simpoziumin me temë “90 vjetori i Kodit të Parë Civil Shqiptar 91929). Përqsaje historike dhe aktuale. Baltasar Benussi, themeluesi i doktrinës të së drejtës civile në Shqipëri”, organizuar nga Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, 9 maj 2019. Ky punim nuk referohet që të jetë publikuar ose botuar dhe për pasojë, nuk do të përfshihet në këtë tregues por është referuar dhe konsideruar në pikëzimin e treguesit “*Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë*”.

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, ndihmësmagjistrati për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë, për shkak se rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2019-31.12.2019.

³⁵Formularit të vetëvlerësimit të ndihmësmagjistratit, i është bashkëlidhur edhe kopja e botimit në revistën përkatëse të avokatisë.

Angazhimi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i ndihmësmagjistratit dhe për këtë ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

| Niveli i vlerësimit | |
|--|-------|
| AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL | |
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

| Niveli i vlerësimit për çdo kriter | | |
|--|-------|---------------------|
| Kriteri | Pikët | Niveli i vlerësimit |
| 1. Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 2. Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit | 98 | Shkëlqyeshëm |
| 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional | 100 | Shkëlqyeshëm |
| Niveli i përgjithshëm i vlerësimit | | |
| Vlerësimi i përgjithshëm | 398 | Shkëlqyeshëm |

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I
VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
NDIHMËSMAGJISTRAT NË GJYKATË TË LARTË NË
PERIUDHËN E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019**

1. AFTËSITË PROFESIONALE E NDIHMËSMAGJISTRATIT

| Treguesit | | Burimet | Niveli |
|-----------------------------|---|---|---------------|
| A. Njohuritë ligjore | a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave | 1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë | Shumë e lartë |

| | | | |
|----------------------------|--|--|---------------|
| | | 3. Relacionet e përzgjedhura me short | |
| | b. Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore material ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës apo opinionit ligjor | 1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë 3. Relacionet e përzgjedhura me short | Shumë e lartë |
| B. Arsyetimi ligjor | a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor | 1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë 3. Relacionet e përzgjedhura me short | Shumë e lartë |
| | b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor | 1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë 3. Relacionet e përzgjedhura me short | Shumë e lartë |
| | c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik | 1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe vlerësimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë 3. Relacionet e përzgjedhura me short | Shumë e lartë |

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE E NDIHMËSMAGJISTRATIT

| Tregues | | Burimet | Niveli |
|---|--|--|--------------|
| A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë | a. Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore | 1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Mbi standard |
| | b. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore | 1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | +99% |

| | | | |
|--|--|--|--|
| B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara | a. Respektimi i standardeve minimale kohore | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | 0-10% |
| | b. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relativitet | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve |
| C. Metodologjia e punës (Aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës) | a. Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Shumë e lartë |
| | b. Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Shumë e lartë |
| | c. Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore | <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Mbi mesataren |

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

| Tregues | | Burimet | Niveli |
|-------------------------|---|--|--------------------|
| A. Etika në punë | a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion | 1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Shumë e lartë |
| B. Integriteti | a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti | 1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI | Shumë e lartë |
| C. Paanësia | a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese | 1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Shumë e lartë |
| | b. Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari | 1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 3. Mendimi i Kryetarit | I pakonsiderueshëm |

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

| Tregues | | Burimi | Niveli |
|---------------------------------------|--|--|---------------|
| A. Aftësia e komunikimit | a. Komunikimi i qartë dhe transparent | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit | Shumë e lartë |
| | b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kolegjit dhe i Kryetarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short | I lartë |
| B. Aftësia për të bashkëpunuar | a. Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave | Shumë e lartë |

| | | | |
|--|---|--|-----------------------------------|
| | e njohurive dhe përvojës profesionale me ta | | |
| | b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kryetarit | Ka të dhëna |
| | c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kryetarit | Shumë e lartë |
| C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera | a. Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Dosja personale e ndihmësmagjistratit 3. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 4. Dokumente të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati | 5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare) |
| | b. Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve | 1. Dosja personale e ndihmësmagjistratit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera | Ka të dhëna |
| | c. Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë | 1. Vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit 2. Mendimi i Kryetarit 3. Dosja personale e ndihmësmagjistratit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të ndihmësmagjistratit | Ka të dhëna |
| | ç. Publikimet ligjore akademike | 1. Dosja personale e ndihmësmagjistratit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij | Ka të dhëna |
| PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT | | | |
| NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT | | | Sh |

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

